



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 07

Datë: 16. 04. 2019. Ora: 15:30

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë.

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ.

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Sami Hamiti, Florian Dushi, Adnan Rrustemi, Nazlije Bala, Ercan Spat, Stevan Veselinoviq, Alfred Kinolli, Cemajl Kurtish.

SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ, Valmira Selmani (ZRPP).

Përkthyes: Vera Dula. **Procesmbajtës:** Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

-Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nr. 06/2019

2. **Raport i Këshillave të KQZ-së:**

- **Këshilli për Operacione Zgjedhore:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i emërimeve të anëtarëve të KKZ-ve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në komunat: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok, dhe Zveçan;

3. **Të ndryshme**
-

1. Hyrie: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

Valdete Daka: E kemi rendin e ditës, a ka ndokush vërejtje, propozim...? Nëse jo, kush është për këtë rend dite...?

Anëtarët e KQZ-së, e miratuan rendin e ditës.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nr. 06/2019

Valdete Daka: E kemi procesverbalin për miratim. A ka dikush vërejtje...? Nëse jo, kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, e miratuan procesverbalin nr. 06/2019

3. Raport i Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Operacione Zgjedhore:

Shqyrtimi dhe miratimi i emërimeve të anëtarëve të KKZ-ve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në komunat: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok, dhe Zveçan.

Adnan Rustemi: Në mbledhjen e fundit, KOZ ka shqyrtuar nominimet e anëtarëve të KKZ-ve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në komunat: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok, dhe Zveçan. Pas shqyrtimit, KOZ ka dhënë sugjerimet dhe vërejtjet, dhe Sekretariati ka marrë për bazë çdo gjë dhe ka sjellë tabelat, pra janë kryer verifikimet e duhura dhe se, çdo gjë është konform ligjit. Materialet i ka secili anëtarë, të bashkangjitura, dhe për secilën komunë...Nuk po i lexojë me radhë...dhe ne, rekomandojmë miratimin e tyre...Me këtë vendim, përmbillet konstituimi i trupave lokale për secilën komunë...

Florian Dushi: Kam një çështje që ndërlidhet me KK të Leposaviqit...dhe, kjo ka të bëjë me faktin se sipas kësaj përbërje të paraqitur në tabelë, mungon përfaqësuesi i LDK-së...Mungesa e tij, e then parimin e përbërjes që ndërlidhet me aspektin e vendimmarrjes...Sekretariati, e ka propozimin dhe unë kërkoj që të jetë edhe përfaqësuesi i LDK-së...

Adnan Rustemi: Po, pajtohem sepse, ne kemi diskutuar formulën dhe kriteret...Besoj, është ndonjë gabim teknik, por ne duhet ta përfshijmë në formulë dhe të nominuarin, mund ta përshijmë më pastaj...e kemi diskutuar këtë, dhe s'kemi ndonjë asnjë dilemë...Mbase, nuk është parim që duhet ta ndjekim me çdo kusht që ta gjejmë dikë që, edhe nuk ka të drejtë, dhe ta nominojmë në kundërshtim me ligjin, mirëpo kudo ku është e mundur, ne mund ta ndjekim numrin "tek" të vendimmarrjes... Sa i përket Leposaviqit, veç konsideroj që të miratohet tabela me nominimin nga LDK, dhe s'kemi asnjë dilemë...

Valdete Daka: I bie që të shtohet edhe një anëtarë...? Dhe të bëhen 11 anëtarë, pra bashkë me zyrtarin komunal në Leposaviq...

Florian Dushi: Që të lehtësohet puna: i nomnuuari është Veton Avdyli...

Anëtarët e KQZ-së, me këtë plotësim miratuan emërim të anëtarëve të KKZ-ve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në komunat: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok, dhe Zveçan.

4. Të ndryshme

Valdete Daka: Kishte me qenë mirë që ne të njoftohemi nga Sekretariati lidhur me rrjedhën e punëve në këto zgjedhje, pra siç edhe e kemi praktikë që, të njoftohemi rregullisht...

Florian Dushi: Pajtohem plotësisht, dhe një pyetje tjetër: A është kontaktuar OSBE, dhe a i është shkruar siç, u dakorduar në mbledhje...

Valdete Daka: Po, u kemi shkruar dhe jemi në pritje të konfirmimit se, a do të angazhohet OSBE sic, edhe jemi marrë vesh në zgjedhje...